



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Kuvendi

PROJEKTLIGJ

Nr. \_\_\_\_/2023

PËR

DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 93/2015, "PËR TURIZMIN", TË  
NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,  
Kuvendi i Republikës së Shqipërisë,

VENDOSI:

Në ligjin nr. 93/2015, "Për turizmin", të ndryshuar bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

**Neni 1**

Kudo në tekstin e projektligjit, fjala "revokim/in" zëvendësohet me "shfuqizim/in".

**Neni 2**

Në nenin 4 bëhen ndryshimet:

1. Pika 1 ndryshon si më poshtë vijon:

~~"Agjenci udhëtimi" është çdo person fizik ose juridik, i cili, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose si ndërmjetës, merr përsipër t'u ofrojë turistëve dhe personave të tjerë, si individë apo të organizuar në grup, shërbimet e përcaktuara në nenin 47 të këtij ligji. Agjencia e udhëtimit zhvillon veprimtarinë e saj bazuar në kontrata ndërmjetësimi për shitjen e shërbimeve të ofruara nga furnizuesit e shërbimeve të udhëtimit dhe/ose kontrata konsulence me konsumatorin.~~

2. Në pikën 20, fjalët "person fizik dhe juridik" zëvendësohen me fjalët "person fizik ose juridik".

3. Pas pikës 55, të nenit 4, shtohen pikat 56, 57, 58 59, 60, 61, 62, 63, 64, 65, 66, 67, 68, 69, dhe 70 me përmbajtjen si vijon:

56. "Apartament" është njësi banimi, e destinuar për të ofruar shërbime akomodimi për turistët, e përbërë minimalisht nga një dhomë ndenje ose kuzhinë, një ose më shumë dhoma gjumi dhe me të

paktën një tualet.”

57. “Bllok apartamentesh” janë dy ose më shumë apartamente të cilat menaxhohen nga i njëjti sipërmarrës turistik.
58. “Dhomë” nënkupton një njësi të veçantë të një ndërtese rezidenciale / biznesi ose e një njësie banimi, në të cilin ofrohet shërbimi i akomodimit për turistët.
59. “Vilë” është një ndërtesë e veçantë me oborr dhe hapësirë kopshti e destinuar për të ofruar shërbime akomodimi për turistët, në zona turistike.
60. “Hotel Trashëgimi Kulturore” është një strukturë akomoduese e vendosur në objekte të trashëgimisë kulturore, të njohura nga organet përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.
61. “Hotel i shpërndarë” është një strukturë akomoduese, i cili ofron shërbimet e mikpritjes për vizitorët, i përbërë nga shtëpi, apartamente ose dhoma të vendosura në ndërtesa të veçanta, ekzistuese, afër njëra tjetrës, të menaxhuara nga i njëjti sipërmarrës turistik.
62. “Kalendari turistik i aktiviteteve zbavitëse” është programi gjithëvjeter që përfshin të gjitha ngjarjet kulturore, të traditës, sportive dhe natyrore të cilat ofrojnë zbavitje dhe kënaqësi për turistët në të gjithë territorin e Shqipërisë.
63. “Organizata e Menaxhimit të Destinacionit (OMD)” është një entitet udhëheqës organizativ që përfshin institucione publike, aktorë dhe profesionistë të turizmit dhe mundëson partneritete të sektorit të turizmit drejt një vizioni të përbashkët të destinacionit turistik. Struktura administrative e OMD-s varion nga një institucion i vetëm publik, në një model partneriteti publik/privat ose OJF me rol kryesor nisjen, koordinimin dhe menaxhimin e aktiviteteve të tilla si zbatimi i politikave të turizmit, planifikim strategjik, zhvillim produkti, promovim, marketing dhe aktivitete të “biznesit të turizmit”.
64. “Plazh” është hapësira me rërë, zhavorr apo shkëmb, që shtrihet në buzë të ujit të detit, lumit apo liqenit, e identifikuar si e përshtatshme për zonë çlodhjeje, argëtuese dhe që konsiderohet e parrezikshme nga pikëpamja shëndetësore apo e sigurisë për përdorim nga pushuesit;
65. “Plazh i lejuar”, është plazhi i përcaktuar si i tillë nga organet përgjegjëse, në të cilin lejohet të ushtrohet veprimtaria e stacionit të plazhit, në përputhje me kërkesat e këtij ligji;
66. “Sipërmarrës turistik” është personi fizik ose juridik, i krijuar sipas legjislacionit në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, i cili kryen veprimtari në fushën e turizmit”.
67. “Shteg turistik” nënkupton një rrugë kryesisht të pashtuar dhe me një sfond natyror, e pajisur me sinjalistikën dhe infrastrukturen tjetër të nevojshme, për të mundësuar ecjen ose kalimin përgjatë apo drejt vendndodhjeve të vecanta me interes turistik, me qëllim krijimin e eksperiencave rekreative.
68. “Vrojtues plazhi” është personi i kualifikuar për të shpëtuar jetën në ujë dhe për të dhënë ndihmën e parë mjekësore.
69. “Ujëra të brendshme” ka kuptimin e dhënë në ligjin për aktivitetet e turizmit detar.
70. “Zonë breguore” në kuptim të këtij ligji, është zona që përfshin vijën bregdetare, hapësirën detare dhe ujerat e brendshme të Republikës së Shqipërisë, në të cilat zhvillohen aktivitete turistike.

### Neni 3

Neni 8 ndryshon me përmbajtje si vijon:

### “Neni 8

**Institucionet përgjegjëse në fushën e turizmit**

Institucionet përgjegjëse në fushën e turizmit janë:

- a) Ministria përgjegjëse për turizmin;
- b) Agjencia Kombëtare e Turizmit;
- c) Agjencia Kombëtare e Bregdetit;
- ç) njësitë e qeverisjes vendore."

#### Neni 4

Neni 10 shfuqizohet.

#### Neni 5

Pas nenit 11 shtohet neni 11/1 me përmbajtje si më poshtë:

#### "Neni 11/1

#### Këshilli Ndërinstitucional për Statistikat

1. Këshilli Ndërinstitucional për Statistikat në Turizëm (KNST) krijohet si një organ koordinues pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin.
2. KNST kryesohet nga Ministri përgjegjës për turizmin dhe ka në përbërje të tij përfaqësues nga institucionet qendrore dhe vendore si Banka e Shqipërisë, Instituti i Statistikave të Shqipërisë, Ministria përgjegjëse për financat dhe ekonominë, Ministria përgjegjëse për kulturën, Ministria e Brëndshme, njësitë e vetëqeverisjes vendore si dhe aktorë të tjerë, veprimtaria e të cilëve lidhet me statistikat në fushën e turizmit.
3. KNST ka këto detyra:
  - a. të monitorojë veprimtarinë e institucioneve përgjegjëse që merren me procesin e mbledhjes dhe përpunimit të statistikave zyrtare në Republikën e Shqipërisë, sipas rregulloreve të vendosura në fushën e statistikave;
  - b. të përcaktojë dhe miratojë të dhënat që do hidhen në Platformën e Ndërinstitucionale të Statistikave;
  - c. të miratojë metodologjinë e vrojtimeve që do të kryhen, në veçanti të atyre vrojtimeve që kryhen për herë të parë;
  - d. të bashkëpunojë me aktorë të tjerë të fushës së turizmit për të siguruar cilësinë e nevojshme për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave që sigurohet nga bizneset dhe autoritetet lokale;
  - e. të miratojë hartimin e raporteve statistikore në turizëm.
4. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të KNST përcaktohet në rregulloren e miratuar nga ministri përgjegjës për turizmin.
5. KNST mbështetet nga sekretariati teknik, rolin e të cilit e luan struktura përgjegjëse për statistikat në Ministrinë përgjegjëse për turizmin.

#### Neni 6

Neni 14 ndryshon me përmbajtje si vijon:

**“Neni 14  
Funksionet dhe kompetencat e Agjencisë Kombëtare të Turizmit**

Agjencia Kombëtare e Turizmit ka këto funksione dhe kompetenca:

1. Zbaton politikat e qeverisë për marketingun në fushën e turizmit, duke promovuar sektorin e turizmit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar nëpërmjet organizimit të panairove, pjesëmarrjes në panairove ndërkombëtare dhe aktiviteteve të tjera me karakter promovues, me qëllim krijimin e imazhit të Shqipërisë si destinacion turistik në tregun ndërkombëtar.
2. Ofron informacion për vizitorët, udhëtarët dhe turistët, për shërbimet turistike që ofrohen, për produktet dhe destinacionet turistike, për veprimtari e të dhëna të tjera të dobishme.
3. Promovon produktin dhe destinacionet turistike brenda e jashtë vendit, duke bashkëpunuar me zyrat rajonale të turizmit, pushtetin vendor dhe organizma të tjerë që operojnë në fushën e turizmit.
4. Promovon investimet në zonat me prioritet zhvillimin e turizmit, duke bashkëpunuar me institucionet e tjera publike të nxitjes së investimeve në vend.
5. Ndërmerr dhe nxit projekte për turizmin, sipas fushës së vet të veprimtarisë, duke marrë miratimin paraprak të ministrisë përgjegjëse për turizmin.
6. Propozon dhe harton produktet me karakter promocional, në përputhje me tendencat e tregut turistik, dhe realizon prodhimin e tyre.
7. Zbaton strategjinë kombëtare të turizmit për marketingun e sektorit.
8. I propozon ministrit përgjegjës për turizmin ndryshimin e akteve ligjore e nënligjore në fushën e turizmit, duke argumentuar arsyet që lidhen me këto propozime.
9. Monitoron, përmirëson dhe përditëson faqet zyrtare të promocionit të turizmit.
10. Mbledh të ardhurat që realizohen nga marrëveshjet e qirasë, për sipërfaqet e dhëna në përdorim për zhvillimin e turizmit, dhe bën derdhjen e tyre në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi.
11. Kontrollon zbatimin dhe plotësimin e kriterëve për marrëveshjet ekzistuese të qirasë dhe për marrëveshjet e zhvillimit, të lidhura me subjektet “person i stimuluar”.
12. Harton në bashkëpunim institucionet qendrore, njësitë e vetqeverisjes vendore dhe grupet e interesit në fushën e turizmit, kalendarin turistik të aktiviteteve zbavitëse dhe monitoron realizimin e tij.
13. Planifikon, koordinon, orienton dhe promovon kalendarin turistik të ngjarjeve kulturore, të traditës, sportive dhe natyrore që ofrojnë zbavitje dhe kënaqësi për turistët në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
14. Financon nga fondi buxhetor i miratuar për çdo vit, realizimin e projekteve dhe ngjarjeve me karakter krijues e me objekt të veprimtarisë së tyre turizmin, si dhe atyre që janë të përfshira në kalendarin turistik, pas miratimit të ministrit.
15. Krijon të ardhura dytësore nga pagesat e subjekteve të interesuara për promovimin e aktiviteteve dhe për shërbimet turistike në hapësirat e menaxhuara nga Agjencia Kombëtare e Turizmit. Procedura e mbledhjes dhe e përdorimit të këtyre të ardhurave miratohet me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për turizmin dhe ministrit përgjegjës për financat.”

## Neni 7

Në nenit 15, bëhen këto ndryshime:

a) Pika 1, e nenit 15 ndryshon me përmbajtjen si vijon:

“1. Agjencia Kombëtare e Bregdetit, në vijim AKB, është person juridik publik, buxhetor, me seli në Tiranë, në varësi të ministrit përgjegjës për turizmin, që ka për qëllim mbrojtjen dhe ndjekjen e zhvillimit të qëndrueshëm të zonës bregdetare dhe brigjeve të brëndshme, monitorimin dhe inspektimin e kontrollin e veprimtarive turistike, në territorin e Republikës së Shqipërisë, në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit.”.

## Neni 8

Neni 16 shfuqizohet.

## Neni 9

Neni 17 ndryshon si më poshtë

### Funksionet dhe Kompetencat e AKB

“Neni 17

Agjencia Kombëtare e Bregdetit ka këto funksione dhe kompetenca:

- a) Organizimin e punës për menaxhimin e integruar të zonës bregujore;
- b) Sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit nëpërmjet monitorimit, inspektimit dhe kontrollit të veprimtarive turistike në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
- c) Bashkëpunimin me institucionet shtetërore, qendrore e vendore, investitorë dhe aktorë të tjerë vendas apo ndërkombëtarë për shkëmbimin e të dhënave dhe krijimin e të gjitha lehtësive për përmbushjen e qëllimeve e të funksioneve të veprimtarisë së saj.
- d) Nxitjen e investimeve në zonën bregujore;
- e) Bashkërendimin e programeve dhe projekteve zhvilluese me rëndësi për menaxhimin e integruar të zonës bregujore;
- f) Sigurimin e shërbimit të pastrimit të zonës bregujore gjatë sezonit turistik në mbështetje dhe plotësim të shërbimit të ofruar nga organet kompetente të qeverisjes vendore. Procedura e prokurimit publik për sigurimin e shërbimit të pastrimit të zonës bregujore bëhet nga AKB duke zbatuar legjislacionin në fuqi për prokurimin publik.
- g) Kryen inspektime për të gjitha veprimtaritë turistike në përputhje me parashikimet e këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi për inspektimin dhe merr masa administrative për shkeljet e konstatuara;
- h) Ushtron çdo përgjegjësi tjetër të përcaktuar me ligj apo akt nënligjor. ”

## Neni 10

Në shkronjën “c” të pikës 2 të nenit 20, togfjalëshi “ ministrin dhe AKT-në,” zëvendësohet me togfjalëshin “ministrinë përgjegjëse për turizmin”

## Neni 11

Pas nenit 28, shtohet neni 28/1, me përmbajtje si më poshtë:

### "Neni 28/1

#### Standartizimi dhe Administrimi i shtigjeve

Këshilli i Ministrave miraton me propozim të ministrisë përgjegjëse për turizmin, rregulloren për standardizimin dhe administrimin e shtigjeve. Rregullorja përcakton rregullat për regjistrimin dhe kategorizimin e shtigjeve, sinjalistikën, projektimin, hapjen dhe mirëmbajtjen e tyre, të dhënat për shtigjet, ndërhyrjet, rregullat e sjelljes së vizitorëve të shtigjeve, organet përgjegjëse, rregullat për trajnimin dhe certifikimin e shteg mbajtësve si dhe cdo aspekt tjetër që lidhet me standartizimin dhe mirë administrimin e shtigjeve."

## Neni 12

Neni 31 ndryshon me përmbajtjen si vijon:

### "Neni 31

#### Financimi i projekteve dhe veprimtarive në fushën e turizmit

1. Ministria përgjegjëse për turizmin dhe Agjencia Kombëtare e Turizmit, financojnë nga fondi buxhetor i miratuar çdo vit:
  - a) projekte të paraqitura nga persona fizikë, juridikë, vendas ose të huaj, që kanë në objekt të veprimtarisë së tyre fushën e turizmit;
  - b) projekte dhe veprimtari në fushën e turizmit që konsiderohen të rëndësishme së veçantë dhe që kanë një buxhet që arrin mbi 50 për qind të fondit vjetor për projekte.
  - c) projekte dhe veprimtari të ideuara dhe të propozuara nga vetë Ministria përgjegjëse për turizmin dhe Agjencia Kombëtare e Turizmit në fushën e turizmit.
2. Ky fond nuk i nënshtrohet legjislacionit të prokurimit publik.
3. Për realizimin e projekteve dhe veprimtarive në fushën e turizmit, skema e financimit mbulon deri në 100% të kostove të miratuara të projektit.
4. Procedurat, që ndiqen për financimin e projekteve sipas shkronjës "b", të pikës 1, të këtij neni, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave."

## Neni 13

Pas nenit 31, shtohen nenet 31/1, 31/2 dhe 31/3 me përmbajtjet si vijon:

### "Neni 31/1

#### Miratimi i projekteve dhe veprimtarive në fushën e turizmit nga Ministria përgjegjëse për turizmin

1. Miratimi i projekteve dhe veprimtarive në fushën e turizmit bëhet nga ministri përgjegjës për turizmin, me propozimin e kolegjiut, të përbërë nga 5 (pesë) nëpunës të administratës publike

të nivelit të lartë dhe të mesëm, drejtues të strukturave përgjegjëse, që mbulojnë fushën e turizmit në ministrinë përgjegjëse për turizmin, të cilët përcaktohen me urdhër të Ministrit përgjegjës për turizmin.

2. Kriteret dhe afatet në lidhje me kërkesë-propozimet për mbështetje financiare, të parashikuara në shkronjat "a" dhe "c" të pikës 1, të nenit 31, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për turizmin.

#### Neni 31/2

#### Kompetencat e kolegjiut në Ministrinë përgjegjëse për turizmin

1. Kolegjiut ka këto kompetenca:
  - a) përzgjedh dhe klasifikon projektet nga pikëpamja e vlerave promovuese, sociale dhe ekonomike në funksion të turizmit;
  - b) harton dhe propozon Ministrin përgjegjës për turizmin veprimtari dhe projekte në fushën e turizmit, në përputhje me përcaktimet e bëra në nenin 31 të këtij ligji;
  - c) nxit promovimin turistik kombëtar dhe i propozon ministrit përgjegjës për turizmin organizimin e eventeve promovuese kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e turizmit.
2. Mënyra e funksionimit të kolegjiut përcaktohet në rregulloren e miratuar nga ministri përgjegjës për turizmin.

#### Neni 31/3

#### Miratimi i projekteve dhe veprimtarive në fushën e turizmit nga Agjencia Kombëtare e Turizmit

1. Miratimi i projekteve dhe veprimtarive në fushën e turizmit nga Agjencia Kombëtare e Turizmit bëhet me Urdhër të titullarit pas propozimit nga kolegjiut i institucionit përkatës.
2. Kolegjiut ka në përbërje jo më pak se 3 nëpunës ose punonjës të përcaktuar me urdhër të titullarit.
3. Mënyrat e funksionimit të kolegjiut pranë AKT-së propozohen nga institucioni dhe miratohen me rregullore nga Ministri përgjegjës turizmin.

#### Neni 14

Shkronja "a" e nenit 33/1 ndryshon si më poshtë:

"a) është investitor në një strukturë akomoduese me 4 ose 5 yje, në Republikën e Shqipërisë, që ndërtohet sipas parashikimeve të nenit 44 dhe që plotëson kriteret dhe kushtet për t'u certifikuar sipas parashikimeve të nenit 45 të këtij ligji;"

#### Neni 15

Në fjalinë e parë të pikë 5, të nenit 35, fjala "mund" shfuqizohet.

#### Neni 16

Në nenin 43, pas shkronjës "ë" shtohen shkronjat "f", "g", "gj", "h", "i" dhe "j" me përmbajtjen si më poshtë:

- f) "Apartament";
- g) "Bllok apartamentesh";
- gj) "Vilë";
- h) "Hotel Trashëgimi Kulturore"
- i) "Hotel i shpërndarë"
- j) "Dhomë" Standard.

#### Neni 17

Pas nenit 43, shtohet neni 43/1 me këtë përmbajtje:

#### "Neni 43/1

#### Kategorizimi i Strukturave Akomoduese

1. Çdo sipërmarrës turistik, që ushtron veprimtarinë si strukturë akomoduese, brenda 30 ditëve nga regjistrimi në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për ushtrimin e veprimtarisë si strukturë akomoduese, paraqet pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin kërkesën për pajisjen me certifikatë kategorizimi, sipas kriterëve të përcaktuara në aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji."
2. Certifikata e kategorizimit të strukturës akomoduese është pa afat dhe regjistrohet në Regjistrin Qendror të Turizmit, që administrohet nga ministria përgjegjëse për turizmin.
3. Cdo strukturë akomoduese gjatë ushtrimit të veprimtarisë ka detyrimin të kryejë regjistrimin elektronik të klientëve me të dhënat mbi numrin e vizitorëve, netëve të qëndrimit, shtetësinë, rezidencën, gjininë dhe moshën.
4. Cdo strukturë akomoduese gjatë ushtrimit të veprimtarisë ka detyrimin të krijojë një ambient të posaçëm e të veçuar për grumbullimin e mbetjeve dhe largimin e tyre sipas rregullave të parashikuara në aktet e nxjerra nga pushteti vendor.
5. Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrisë përgjegjëse për turizmin, miraton rregulloren për kushtet, kriteret, afatet, si dhe procedurën për kategorizimin e strukturave akomoduese."

#### Neni 18

Në nenin 45 bëhen ndryshimet si më poshtë:

a) Pika 1, ndryshon me këtë përmbajtje:

"1. Secila kategori e strukturave akomoduese klasifikohet me sistem të veçantë, e shoqëruar me shenjat dalluese përkatëse, sipas përcaktimit të mëposhtëm:

- a) "Bujtinë" Standard;
- b) "Fjetinë" Standard, Komfort;
- c) "Kamping" Standard



- e) "Hotel"
- d) "Motel"
- dh) "Resort"
- e) "Qendër kurative"
- ë) "Fjetje dhe mëngjes" (B&B)
- f) "Apartament"
- g) "Bllok Apartamentesh"
- gj) "Vilë"
- h) "Hotel i shpërndarë"
- i) "Hotel Trashëgimi Kulturorë"
- j) "Dhomë"

Dy yje, tre yje, katër yje, pesë yje;  
 Standard, Komfort, Superior;  
 Tre yje, katër yje, pesë yje;  
 Dy yje, tre yje, katër yje, pesë yje;  
 Standard, Komfort, Superior.  
 Standard;  
 Standard;  
 Komfort, Superior;  
 Standard.  
 Standard.

- b) Në pikën 3, fjalët "brenda 30 ditëve" shfuqizohen.
- c) Pika 10, shfuqizohet.

### Neni 19

Pas nenit 45, shtohet neni 45/1 me këtë përmbajtje:

#### "Neni 45/1 Agroturizmi

1. Subjekti për të ushtruar veprimtarinë e agroturizmit plotëson kriteret për:
  - a) fermat e lidhura me veprimtarinë e agroturizmit;
  - b) strukturën pritëse të ndërtuar ose të asaj që parashikohet të ndërtohet;
  - c) ofrimin e ushqimeve dhe pijeve të përgatitura me ingredientë që vijnë nga vetë ferma ose nga prodhuesit lokal;
  - d) ofrimin e aktiviteteve argëtuese/edukative;
2. Veprimtaria e Agroturizmi certifikohet nga ministria përgjegjëse për turizmin, nëpërmjet certifikatës paraprake për ndërtimin e agroturizmit dhe certifikatës për ushtrimin e veprimtarisë së agroturizmit.
3. Kriteret, dokumentacioni dhe procedurat për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit dhe ndërtimin e strukturave/objekteve në funksion të tij, miratohen nga Këshilli Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për turizmin dhe ministrit përgjegjës për zhvillimin rural."

### Neni 20

Në shkronjën "b" të nenit 47 fjalët "operatorëve të udhëtimit" zëvendësohet me fjalët "operatorëve turistik".

### Neni 21

Në shkronjën "c", të pikës 2, të nenit 48, togfjalëshi "të zotërojë një diplomë universitare të ciklit të parë të studimeve ose dëshmi kualifikimi profesional, në përputhje me objektin e veprimtarisë së biznesit", zëvendësohet me "të ketë përfunduar arsimin e mesëm;".

## Neni 22

Në shkronjën “c” të pikës 2, të nenit 51, pas togfjalëshit “ciklit të parë të studimeve” shtohen togfjalëshi “ose të ketë mbaruar shkollën e mesme profesionale”.

## Neni 23

Në nenin 54 bëhen këto ndryshime:

a) Titulli i nenit 54 ndryshon si më poshtë:

“Të dhënat bazë të kontratës me udhëtarin”

b) Në pikën 1, fjala “konsumatorin”, zëvendësohet me “udhëtarin”.

c) Pas shkronjës o, shtohen shkronjat “p” dhe “q” me përmbajtje si më poshtë:

“p) kontaktin e drejtpërdrejtë me personin përgjegjës për fëmijën që nuk është i shoqëruar nga prindërit apo përfaqësuesi tij ligjor;

q) informacion mbi procedurat e trajtimit të ankesave dhe mekanizmat për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve.”

## Neni 24

Neni 55 shfuqizohet.

## Neni 25

Në nenin 57 bëhen këto ndryshime:

a) Pas pikës 1, shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1 Kërkuesi ndjek programin e kualifikimit të udhërrëfyesit turistik, sipas kategorive përkatëse, para paraqitjes së kërkesë për t’u pajisur me certifikatën e udhërrëfyesit turistik, tek ofruesit e miratuar nga ministria përgjegjëse e turizmit. Programi i kualifikimit dhe kushtet që plotësojë ofruesit e këtyre programeve miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës së turizmit.”.

b) Në shkronjën “a” të pikës 5, fjalët “adresën e udhërrëfyesit turistik” shfuqizohen.

~~e) Pika 6 ndryshon si më poshtë:~~

~~“6. Certifikata e udhërrëfyesit turistik është pa afat.”~~

## Neni 26

Në nenin 58 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

- a) Në fjalinë e dytë të pikës 1, fjalët "...i pajisur me të dhënat e përcaktuara në pikën 5, të nenit 57..." zëvendësohen me fjalët "... i cili përmban emrin dhe mbiemrin dhe të dhënat e përcaktuara në shkronjat b - d, të pikës 5, të nenit 57".
- b) Në pikën 5, fjalët "heqjes ose pavlefshmërisë së" zëvendësohen me fjalët "...dhe shfuqizimit të..".

#### Neni 27

Neni 59 shfuqizohet.

#### Neni 28

Neni 60 ndryshon si më poshtë:

#### "Neni 60

#### Kualifikimi dhe edukimi profesional në vazhdim i udhërrëfyesve turistikë

1. Ministria përgjegjëse për turizmin:

- a) miraton programet e kualifikimit të udhërrëfyesit turistik.
- b) nxit, mbështet dhe bashkëpunon me institucionet e akredituara prej saj dhe institucione të tjera për organizimin e kurseve të edukimit profesional në vazhdim dhe të seminareve informuese për udhërrëfyesit turistikë, me qëllim ruajtjen e standardeve të shërbimit të udhërrëfimit turistik, për të përditësuar dhe pasuruar njohuritë e udhërrëfyesit turistik me të dhëna të reja.

2. Ministri përgjegjës për turizmin miraton rregulloren mbi programet e kualifikimit të udhërrëfyesit turistik dhe procedurën për akreditimin e tyre.

#### Neni 29

Në nenin 63 shtohet pika 1/1 me përmbajtje si më poshtë vijon:

1/1. Në cdo rast, transportuesi turistik nuk ushtron veprimtarinë e operatorit turistik. Shërbimi i caktuar rregullohet nëpërmjet kontratës së shërbimit mes operatorit turistik dhe transportuesit turistik i

#### Neni 30

Neni 64, ndryshon si më poshtë:

#### "Neni 64

## Stacionet e plazhit

1. Veprimtaria e stacionit të plazhit ushtrohet bazuar në një kontratë përdorimi për hapësirën e plazhit të vënë në dispozicion, të lidhur midis subjektit dhe autoritetit publik kompetent dhe organizohet në hapësirë në përputhje me hartën e përgjithshme për plazhet e lejuara dhe planvendosjet përkatëse, të miratuara nga organet përgjegjëse.”
- 2 Subjekti që ushtron veprimtarinë e stacionit të plazhit informon pushuesit nëpërmjet afishimit të kriterëve dhe kushteve të sigurisë së shëndetit dhe jetës në aspektet teknike të veprimtarisë së stacionit të plazhit.
3. Subjekti që ushtron veprimtarinë e stacionit të plazhit ka detyrimin të mirëmbajë dhe të parandalojë ndotjen e hapësirës së plazhit që ka marrë në përdorim, sipas pikës 1 të këtij neni.
4. Rregullorja për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për turizmin dhe përmban:
  - a) Kushtet teknike minimale sipas tipologjisë së plazhit;
  - b) Kërkesat për sigurinë shëndetësore dhe higjenën;
  - c) Kërkesat për sigurinë;
  - ç) Kërkesat dhe kushtet për vrojtuesin e plazhit.”

### Neni 31

Pas nenit 64 shtohet neni 64/1 me përmbajtje:

#### “Neni 64/1

#### Detyrime të tjera për sipërmarrjet turistike

1. Çdo sipërmarrës turistik ekspozon në vend të dukshëm për publikun emrin e biznesit, si dhe procedurën e ankimit, në gjuhën shqipe dhe angleze.
2. Çdo strukturë akomoduese dhe stacion plazhi ekspozon dukshëm listat e çmimeve për produktin dhe shërbimin që ofron në gjuhën shqipe dhe angleze.
3. Çdo sipërmarrës turistik, gjatë ushtrimit të veprimtarisë garanton sigurimin e standardeve të shërbimit që ofron, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.
4. Çdo sipërmarrës turistik, gjatë ushtrimit të veprimtarisë duhet të lidhë një kontratë të vlefshme sigurimi për sigurimin e përgjegjësive ndaj palëve të treta si rezultat i mospërbushjes së detyrimeve, përfshirë aftësinë paguese dhe falimentimin. Kontrata e Sigurimit lidhet me një shoqëri sigurimi, në përputhje me dispozitat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për sigurimet dhe risigurimet si dhe mbulon dëmet e parashikuara më sipër, si dhe ato të parashikuara në kuadrin ligjor për mbrojtjen e konsumatorit.
5. Çdo sipërmarrës turistik ka detyrimin të vendosi në një vend të dukshëm për publikun kontratën e sigurimit të përgjegjësive ndaj palëve të treta.

6. Çdo sipërmarrës turistik, i cili ofron shërbimet e veta online, ka detyrimin që në faqen e tij të publikojë informacionin sipas pikave 1, 2 dhe 5 të këtij neni.

### Neni 32

Neni 66 ndryshon me përmbajtje si vijon:

#### “Neni 66

#### **Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave statistikore**

1. Struktura përgjegjëse për të dhënat statistikore, në ministrinë përgjegjëse për turizmin, siguron të dhëna me bazë mujore nga:
  - a) “Institucionet publike qendrore dhe vendore, përgjegjëse për furnizimin me të dhëna administrative, si dhe përgjegjëse për prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave zyrtare, personat fizikë dhe juridikë, njësitë ekonomike, në përputhje dhe në zbatim të akteve ligjore e nënligjore, në kuadër të fushëveprimit të prodhuesve të statistikave zyrtare;
  - b) Strukturat akomoduese, për numrin e vizitorëve, numrin e netëve të qëndrimit, shtetësinë, rezidencën, gjininë dhe moshën;
  - c) Operatorët turistikë dhe agjencitë e udhëtimit, për numrin total të vizitorëve për turizmin pritës dhe turizmin në dalje, shtetësinë dhe destinacionin.
2. Subjektet e parashkuara në shkronjën “a” dhe “b” dhe “c” të pikës 1 të këtij neni, kanë detyrimin të raportojnë të dhëna të vërteta dhe të sakta sipas parimeve të statistikave zyrtare të cilat ruhen për një afat trevjeçar.
3. Të dhënat sigurohen pa pagesë në formën dhe kohën e kërkuar.
4. Të dhënat e vëna në dispozicion të ministrisë përgjegjëse për turizmin përdoren vetëm për qëllime statistikore.”

### Neni 33

Pika 2 e nenit 68 ndryshon si më poshtë:

“2. Ministria përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për turizmin nxisin edukimin profesional në fushën e turizmit, me qëllim ruajtjen e standardeve dhe përmirësimin e shërbimit të ofruar nga sektori i turizmit”.

---

### Neni 34

---

Neni 71 ndryshon me përmbajtje si vijon:

#### “Neni 71

#### **Kundërvajtjet administrative**

1. Kur nuk përbëjnë vepër penale, shkeljet e mëposhtme janë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë, përkatësisht:
  - a) Ushtrimi i veprimtarisë si strukturë akomoduese pa certifikatë kategorizimi, sipas nenit 43/1

- dënohet me gjobë, bazuar në numrin e dhomave, si më poshtë:
- i. nga 1 deri në 5 dhoma me 20 000-50 000 lekë
  - ii. nga 6 deri në 15 dhoma me 100 000 lekë;
  - iii. nga 16 deri në 40 dhoma me 200 000 lekë;
  - iv. nga 41 deri në 80 dhoma me 300 000 lekë;
  - v. mbi 80 dhoma me 400 000 lekë.
- b) përdorimi i paautorizuar apo i gabuar i shenjave dalluese në strukturën akomoduese, pa u kryer procesi i klasifikimit sipas nenit 45 dënohet me gjobë 200 000 lekë;
- c) ushtrimi i veprimtarisë si agroturizëm pa certifikatën përkatëse sipas nenit 45/1 dënohet me gjobë, bazuar në numrin e dhomave, si më poshtë:
- i. deri në 5 dhoma 50 000 lekë;
  - ii. mbi 5 dhoma 100 000 lekë.
- ç) mos respektimi i kriterëve për ushtrimin e veprimtarisë së agroturizmit, sipas parashikimeve të nenit 45/1 dënohet me gjobë 100 000 lekë;
- d) ushtrimi i veprimtarisë pa licencën përkatëse, sipas pikës 1, të nenit 48, dënohet me gjobë 200 000 lekë;
- dh) ushtrimi i veprimtarisë pa licencën përkatëse, sipas pikës 1, të nenit 51, dënohet me gjobë 300 000 lekë;
- e) ushtrimi i veprimtarisë pa plotësuar kërkesat e përcaktuara, sipas parashikimeve të pikave 1 e 2, të nenit 53, dënohet me gjobë 100 000 lekë;
- ë) ushtrimi i veprimtarisë pa kontratë ose pa plotësuar të dhënat bazë të përcaktuara në pikën 1, të nenit 54, dënohet me gjobë 100 000 lekë;
- f) ushtrimi i veprimtarisë pa certifikatë, sipas pikës 1, të nenit 57, dënohet me gjobë 100 000 lekë;
- g) ushtrimi i veprimtarisë pa plotësuar kërkesën e përcaktuar në pikën 2, të nenit 58, dënohet me gjobë 20 000 lekë;
- gj) ushtrimi i veprimtarisë pa plotësuar kërkesat e përcaktuara në pikën 1, të nenit 61, dënohet me gjobë 100 000 lekë;
- h) mosrespektimi i kushteve dhe kriterëve sipas pikës 2 të nenit 63, dënohet me gjobë 100 000 lekë;
- i) Mosrespektimi i detyrimit për mbajtjen në mjetin e transportit të kontratës së lidhur me transportuesit turistik dhe operatorit turistik apo agjencisw së udhëtimeve sipas parashikimeve të pikës 1/1 të nenit 63 dënohet me gjobë 50 000 lekë;
- j) ushtrimi i veprimtarisë pa kontratën përkatëse, sipas pikës 1, të nenit 64, dënohet me gjobë 300 000 lekë;
- k) mosafishimi në mënyrë të dukshme i kërkesave të sigurisë në stacionin e plazhit, sipas pikës 2 të nenit 64 të këtij ligji, dënohet me gjobë 50 000 lekë.
- l) mosmirëmbajtja dhe ndotja e hapësirës së stacionit të plazhit, sipas pikës 3 të nenit 64 të këtij ligji, dënohet me gjobë 200 000 lekë.
- m) moszbatimi i kushteve minimale teknike sipas tipologjisë së plazhit sipas pikës 4 të nenit 64 dënohet me gjobë 100 000 lekë;
- n) moszbatimi i kërkesave për kushtet e higjenes sipas sipas pikës 4 të nenit 64 dënohet me gjobë 200 000 lekë;
- nj) moszbatimi i kërkesave për sigurinë në stacionin e plazhit sipas pikës 4 të nenit 64 dënohet me gjobë 200 000 lekë;

dënohet me gjobë, bazuar në numrin e dhomave, si më poshtë:

- i. nga 1 deri në 5 dhoma me 20 000-50 000 lekë
- ii. nga 6 deri në 15 dhoma me 100 000 lekë;
- iii. nga 16 deri në 40 dhoma me 200 000 lekë;
- iv. nga 41 deri në 80 dhoma me 300 000 lekë;
- v. mbi 80 dhoma me 400 000 lekë.

b) përdorimi i paautorizuar apo i gabuar i shenjave dalluese në strukturën akomoduese, pa u kryer procesi i klasifikimit sipas nenit 45 dënohet me gjobë 200 000 lekë;

c) ushtrimi i veprimtarisë si agroturizëm pa certifikatën përkatëse sipas nenit 45/1 dënohet me gjobë, bazuar në numrin e dhomave, si më poshtë:

- i. deri në 5 dhoma 50 000 lekë;
- ii. mbi 5 dhoma 100 000 lekë.

ç) mos respektimi i kriterëve për ushtrimin e veprimtarisë së agroturizmit, sipas parashikimeve të nenit 45/1 dënohet me gjobë 100 000 lekë;

d) ushtrimi i veprimtarisë pa licencën përkatëse, sipas pikës 1, të nenit 48, dënohet me gjobë 200 000 lekë;

dh) ushtrimi i veprimtarisë pa licencën përkatëse, sipas pikës 1, të nenit 51, dënohet me gjobë 300 000 lekë;

e) ushtrimi i veprimtarisë pa plotësuar kërkesat e përcaktuara, sipas parashikimeve të pikave 1 e 2, të nenit 53, dënohet me gjobë 100 000 lekë;

ë) ushtrimi i veprimtarisë pa kontratë ose pa plotësuar të dhënat bazë të përcaktuara në pikën 1, të nenit 54, dënohet me gjobë 100 000 lekë;

f) ushtrimi i veprimtarisë pa certifikatë, sipas pikës 1, të nenit 57, dënohet me gjobë 100 000 lekë;

g) ushtrimi i veprimtarisë pa plotësuar kërkesën e përcaktuar në pikën 2, të nenit 58, dënohet me gjobë 20 000 lekë;

gj) ushtrimi i veprimtarisë pa plotësuar kërkesat e përcaktuara në pikën 1, të nenit 61, dënohet me gjobë 100 000 lekë;

h) mosrespektimi i kushteve dhe kriterëve sipas pikës 2 të nenit 63, dënohet me gjobë 100 000 lekë;

i) Mosrespektimi i detyrimit për mbajtjen në mjetin e transportit të kontratës së lidhur me Transportuesit turistik dhe operatorit turistik apo agjencisw sipas parashikimeve të pikës 1/1 të nenit 63 dënohet me gjobë 50 000 lekë;

~~j) ushtrimi i veprimtarisë pa kontratën përkatëse, sipas pikës 1, të nenit 64, dënohet me gjobë 300 000 lekë;~~

~~k) mosafishimi në mënyrë të dukshme i kërkesave të sigurisë në stacionin e plazhit, sipas pikës 2 të nenit 64 të këtij ligji, dënohet me gjobë 50 000 lekë.~~

~~l) mosmirembajtja dhe ndotja e hapësirës së stacionit të plazhit, sipas pikës 3 të nenit 64 të këtij ligji, dënohet me gjobë 200 000 lekë.~~

~~m) moszbatimi i kushteve minimale teknike sipas tipologjisë së plazhit sipas pikës 4 të nenit 64 dënohet me gjobë 100 000 lekë;~~

~~n) moszbatimi i kërkesave për kushtet e higjenes sipas sipas pikës 4 të nenit 64 dënohet me gjobë 200 000 lekë;~~

~~nj) moszbatimi i kërkesave për sigurinë në stacionin e plazhit sipas pikës 4 të nenit 64 dënohet me gjobë 200 000 lekë;~~

- o) mosplotësimi i kërkesave dhe kushteve për vrojtuesin e plazhit sipas pikës 4 të nenit 64 dënohet me gjobë 100 000 lekë;
- p) ushtrimi i veprimtarisë si stacion plazhi jashtë sipërfaqes së përcaktuar në kontratë, dënohet me gjobë 150 000 lekë;
- q) mungesa e vrojtuesit të plazhit në stacionin e plazhit dënohet me gjobë 200 000 lekë;
- r) mungesa e kontratës së sigurimit për sigurimin e përgjegjësishë ndaj palëve të treta sipas pikës 4 të nenit 64/1, nga sipërmërrësit turistik, dënohet me gjobë 200 000 lekë;
- rr) mos zbatimi i detyrimeve të përcaktuara në pikën 1 dhe 2 të nenit 64/1 dënohet me gjobë nga 50 000 lekë;
- s) mosdeklarimi i të dhënave statistikore nga strukturat akomoduese për numrin e vizitorëve, numrin e netëve të qëndrimit, shtetësinë, rezidencën, gjininë dhe moshën, sipas nenit 66 dënohet me gjobë 150 000 lekë;
- rr) deklarimi i pasaktë i të dhënave statistikore sipas nenit 66 dënohet me gjobë 100 000 lekë;
2. Gjoha, në zbatim të këtij neni, përbën titull ekzekutiv me përfundimin e shqyrtimit të ankimit administrativ, dhe vendoset nga struktura përgjegjëse inspektuese në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për inspektimin”.
3. Gjoha, e parashikuar në pikën 2 të këtij neni, paguhet brenda 10 ditëve nga data kur vendimi i dënimit me gjobë është bërë titull ekzekutiv, në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative”.

### Neni 35

#### Aktet nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave dhe ministri përgjegjës për turizmit që brenda 12 muajve nga miratimi i këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim tij.

### Neni 36

#### Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**LINDITA NIKOLLA**



**|| RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT**

<b>EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS</b>	Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar”
<b>MINISTRIA UDHËHEQËSE</b>	Ministria e Mjedisit dhe Turizmit
<b>FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT</b>	Konsultim
<b>BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS</b>	I brendshëm
<b>DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së</b>	Jo e zbatueshme
<b>PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Strategjia Kombëtare “Për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019 – 2023”;</li> <li>• Raportet INSTAT “Lëvizjet e shtetasve” dhe “Strukturat akomoduese”</li> </ul>
<b>DATA E KONSULTIMIT PUBLIK</b>	Data/Asnjë konsultim publik
<b>DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT</b>	Data e vlerësimit të ndikimit
<b>A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT?</b>	Po/Jo
<b>NËSE PO, JEPNI DATEN E SHQYRTIMIT</b>	Data e shqyrtimit
<b>NUMRI VLERËSIMIT TË NDIKIMIT</b>	Viti - MI - Nr. VN
<b>TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)</b>	Elton Orozi Elton.Orozi@turizmi.gov.al

**PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (maksimumi 2 faqe)**

**PËRKLUFIZIMI I PROBLEMIT**

Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Jepni arsyet e nevojës së ndërhyrjes së qeverisë. (jo më shumë se 10 rreshta)

Me dinamikën e fortë të zhvillimit të industrisë së turizmit, përtej vështirësive që ju imponuan këtij sektori, pas situatës dramatike të tërmetit të nëntorit të vitit 2019 dhe cikleve të njëpasnjëshme të pandemisë së Covid 19, që kulmuan përgjatë vitit 2020 me një rënie prej rreth 60% të numrit të vizitorëve dhe turistëve, industria e turizmit po

konsolidohet me një ritëm të qëndrueshëm, si një nga sektorët prioritarë të zhvillimit ekonomik të vendit.

Bazuar në raportin e “Impaktit ekonomik të udhëtimeve dhe turizmit”<sup>1</sup> të vitit 2022, të Këshillit Botëror të Udhëtimit dhe Turizmit (WTTC), përgjatë vitit 2021, sektori i turizmit regjistroi një kontribut total në ekonomi prej 3,1 miliard USD, që përbën rreth 17.4 % të PBB-së, duke e pozicionuar Shqipërinë në vendin e 14-të në botë për kontributin në ekonomi të industrisë së turizmit dhe sipas Indeksit të Zhvillimit të Udhëtimeve dhe Turizmit 2021 të Forumit Ekonomik Botëror (WEF) një nga tre vendet evropiane së bashku me Malin e Zi dhe Kroacinë, me varësinë më të lartë nga ky sektor.

Në këtë kuadër, duke marrë në konsideratë trendet e reja të udhëtimeve të shfaqura pas pandemisë së COVID 19, zhvillimin institucional dhe administrativ të institucioneve përgjegjëse për administrimin dhe zhvillimin e këtij sektori, nevojën për të siguruar një sektor konkurrues dhe funksional, nevojën për të vendosur kritere të përshtatshme për sigurimin e standardeve në ushtrimin e aktiviteteve turistike, janë identifikuar si problematike në sektorin e turizmit:

- i. Operimi si struktura akomoduese në mënyrë informale i dhomave, apartamenteve dhe vilave, duke cënuar konkurrencën me subjektet formale, cilësinë e shërbimeve etj;
- ii. Humbja e koherencës së disa funksioneve të parashikuara për t’u siguruar nga Degët Territoriale të Turizmit si dhe nevoja për përmirësimin e funksioneve dhe përgjegjësive të Agjencisë Kombëtare të Turizmit dhe Agjencisë Kombëtare të Bregdetit;
- iii. Mungesa në destinacion e një strukture koordinuese me pushtetin vendor, bizneset e grupet të interesit, në hartimin dhe zbatimin e planeve e programeve të turizmit;
- iv. Nevoja e një procesi efektiv mbi propozimin dhe përzgjedhjen e projekteve- në fushën e turizmit për financim, duke synuar krijimin e një ambienti nxitës për kërkesë - propozime inovative nga çdo individ apo entitet;
- v. Domsdoshmëria për të ripërcaktuar, lehtësuar dhe definuar saktësisht disa procese që lidhen me certifikimin e udhërrëfyesve turistikë, licencimin e operatorëve turistikë dhe agjencive të udhëtimit, parashikimin, përmirësimin dhe lehtësimin e kritereve për ushtrimin e veprimtarisë turistike si “Agroturizëm”, “Stacion plazhi” si dhe nevojën për transparencën e çmimeve dhe të procesit të ankimit nga çdo subjekt turistik që i nënshtrohet përcaktimeve të këtij ligji;
- vi. Mungesa e mbledhjes së të dhënave statistikore të plota, të vërteta dhe në kohë reale;
- vii. Mungesa e sigurimit të përgjegjesisë ndaj palëve të treta për subjektet që operojnë në turizëm;
- iii. Nevoja për vendosjen e standardeve dhe rritjen e sigurisë në shtigjet që përdoren për ecje ose kalim përgjatë apo drejt vendndodhjeve të vecanta me interes turistik, me qëllim krijimin e eksperiencave rekreative;

<sup>1</sup> [https://wttc.org/DesktopModules/MVC/FactSheets/pdf/704/28\\_20220613152800\\_Albania2022\\_.pdf](https://wttc.org/DesktopModules/MVC/FactSheets/pdf/704/28_20220613152800_Albania2022_.pdf)

ix. Nevoja për të përmirësuar mënyrën e kontrollit të zbatimit të përcaktimeve ligjore nga ana e subjekteve dhe vendosjes së masës së gjobës si titull ekzekutiv.

Nisur nga problematikat e identifikuara më lart, lind nevoja për ndërhyrje të qeverisë për përmirësimin e kuadrit ligjor për turizmin.

## **OBJEKTIVAT**

*Cilat janë objektivat dhe rezultatet e synuara të propozimit? (jo më shumë se 7 rreshta)*

Nëpërmjet ndërhyrjeve të propozuara, synohet arritja e objektivave të mëposhtme:

- a) Uljen e informalitetit në dhe përmirësimin e ofrimit të shërbimit të akomodimit nëpërmjet identifikimit të ofruesve të akomodimit në segmentin e strukturave akomoduese jotregtare (dhoma, vila, apartamente)
- b) Mbrojtjen e konsumatorit nëpërmjet detyrimit të shtuar të çdo sipërmarrësi turistik, ku ky i fundit gjatë ushtrimit të veprimtarisë duhet të ketë një kontratë të vlefshme sigurimi për sigurimin e përgjegjësisë ndaj palëve të treta si rezultat i mospërbushjes së detyrimeve, përfshirë aftësinë paguese dhe falimentimin;
- c) Përmirësimin e funksioneve të disa institucioneve përgjegjëse në fushën e turizmit si: Ministria përgjegjëse për turizmin, Agjencia Kombëtare e Turizmit, Agjencia Kombëtare e Bregdetit dhe njësitë e vetqeverisjes vendore.
- d) Rritja e funksionalitetit të sistemit të certifikimit të shërbimeve turistike (udhërrëfyes turistikë, stacione plazhi, agroturizëm, struktura akomoduese etj); Përcaktimin e rregullave mbi standardizimin dhe administrimin e shtigjeve turistike;
- e) Riorganizimin e procesit të mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave statistikore për turizmin nëpërmjet Këshillit Ndërinstitucional për Statistikat, si një organ i ri i ngritur pranë MTM-së;
- f) Ngritjen e një strukture të posaçme/ Kolegjiumi pranë MTM-së, për vlerësimin e projekteve dhe veprimtarive në turizëm;
- g) Forcimin dhe kontrollin e masave ndëshkuese për moszbatim të kërkesave ligjore për turizmin, duke e kthyer gjobën në titull ekzekutiv.

## **OPSIONET E POLITIKAVE**

*Cilat janë opsionet kryesore të politikave? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. (jo më shumë se 7 rreshta)*

Për arritjen e objektivave të politikës janë marrë në konsideratë opsionet e mëposhtme:

### **Opsioni 0-(status quo)**

Ky opsion nënkupton mos ndërhyrjen me ndryshim apo politikë të re, duke vijuar me administrimin dhe zhvillimin e sektorit të turizmit në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi.

Gjendja e legjislacionit aktual, duke mos ndërhyrë me nisma legjislativenuk përmbush objektivat e përcaktuara më sipër si dhe nuk mundëson përfshirjen e ofruesve të shërbimit të akomodimit në zinxhirin e aktiviteteve formale, duke minimizuar mundësitë për të patur një nivel të reduktuar të informalitetit dhe shërbime të standardizuara. Po ashtu, kostot dhe përfitimet për aktorët e përfshirë në sektorin e turizmit do të jenë të pandryshueshme për arsye se problemet e identifikuar nuk do të adresohen dhe nuk do të gjejnë zgjidhje në funksion të zhvillimeve të këtij sektori.

### **Opsioni 1**

Përgatitja e një ligji të ri sektorial me ndryshime të dukshme në krahasim me draftin e propozuar. Nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje rregullatore, do të kërkojë të përcaktohen përkufizime, kritere dhe procedura të reja, institucione përgjegjëse të reja me role dhe përgjegjësi të riformuluara. Hartimi i ligjit të ri tetë vite pas miratimit të ligjit të mëparshëm, (që nga viti 2015) duke sjellë ndryshime thelbësore, është jo i favorizuar pasi do të kërkonte për pasojë një periudhë të rëndësishme tranzicioni, të përshtatjes së industrisë së turizmit në përputhje me kuadrin e ri rregullator si dhe të strukturave shtetërore përgjegjëse për turizmin për njohjen dhe zbatimin e tij. Gjithashtu ai do të krijonte një pasiguri tek palët e interesuara për paqëndrueshmërinë e politikave qeveritare përkundrejt zhvillimit të këtij sektori të rëndësishëm të ekonomisë. Për më tepër, ndryshimet e propozuara mund të adresohen në ligjin ekzisues, pa prekur parimet thelbësore të ligjit dhe për rrjedhojë nuk është e nevojshme të hartohet një ligj i ri për turizmin.

Kostot për buxhetin e shtetit llogaritet të jenë në vlerën 10 milionë lekë vetëm për vitin e parë të zbatimit, si edhe 6 milionë lekë kosto për biznesin, **pra në total, sipas këtij opsioni parashikohet të jenë në vlerën 16 milionë lekë.**

### **Opsioni 2**

Miratimi i projektligjit sikurse është propozuar, i cili konsiston në ndryshime të ligjit ekzisues 93/2015. Nëpërmjet kësaj politike synohen rregullime në legjislacionin në fuqi për çështje të caktuara që lidhen me zhvillimin e sektorit, të identifikuar si problematike apo në nevojën për përmirësim, përgjatë viteve të zbatimit të tij. Ndryshimet do të jenë të një karakteri të përgjithshëm dhe nuk do të prekin thelbin e ligjit. Ndryshimet e fokusuar në vetëm disa çështje të caktuara, do të jenë të lehta për tu zbatuar nga të gjithë palët, sektori privat dhe sektori publik, duke rritur efektivitetin e nismës dhe uljen e kostove. Kosto për buxhetin e shtetit nuk parashikohet të ketë.

Parashikohet të ketë kosto të shtuara për bizneset që ushtrojnë veprimtari turistike për shkak të detyrimit për kontratën e sigurimit, kosto e cila llogaritet të arrijë vlerën 6 milionë lekë në vitin e parë pas miratimit të ligjit, **pra në total sipas opsionit 2, parashikohet që kostot të jenë në vlerën 6 milionë lekë.**

Ky opsion ka efekt pozitiv financiar më të lartë në buxhetin e shtetit se opsioni 1.

## ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare. (jo më shumë se 7 rreshta)

Opsioni i preferuar është përzgjedhur Opsioni 2, ndryshimi i ligjit ekzistues nr.93/2015 "Për turizmin", i ndryshuar. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka bërë fillimisht analizën e vlerësimit të zbatimit në praktikë të ligjit si dhe të mangësive ligjore duke marrë si model edhe legjislacionet e turizmit të vendeve të rajonit si Kroaci, Mali i Zi, nëpërmjet të cilës u identifikuan ndërhyrjet që duheshin ndërmarrë në dhënien e përkufizimeve të reja, procese të thjeshtuara, kritere, procedura dhe institucione me funksione të përmirësuara, të cilat do të lehtësojnë zhvillimin e sektorit të turizmit, duke siguruar një efekt zinxhir që lidhet me rritjen e investimeve, zhvillimin e projektveve, rritjen e punësimit etj.

Nga pikpamja e analizës kosto-përfitim, opsioni i propozuar **nuk parashikohet të sjellë kosto shtesë për buxhetin e shtetit**. Parashikohet të rriten kostot e biznesit që ushtrojnë veprimtari turistike për shkak të detyrimit për kontratën e sigurimit, kosto e cila llogaritet të arrijë vlerën 6 milionë në vitin e parë pas miratimit të ligjit.

Për sa më sipër, ky është opsioni më fitimprurës për buxhetin e shtetit në krahasim me opsionet e tjera. Vlera prezente neto aktuale që synohet të arrihet nëpërmjet këtij opsioni është 117 milionë lekë për 10 vjet.

**Kostoja e përlllogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):**

Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025
0	0	0

### KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar? (jo më shumë se 5 rreshta)

Projektligji është hedhur për konsultim në regjistrin elektronik të konsultimeve publike në datë 3.10.2023 deri më datë 31.10.2023, si dhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

Për këtë projektligj kanë shprehur komente dhe sugjerime shoqata, subjekte dhe individë si më poshtë:

- Active Albania
- Unioni Turistik Shqiptar
- Shoqata e Agroturizmit Shqiperi
- Unioni Turistik Shqiptar/Enton Diamant
- Dhoma Amerikane e Tregtisë
- Shoqata Shqiptare e Turoperatoreve & Agjencive Turistike.

## ZBATIMI DHE MONITORIMI

*Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi? (jo më shumë se 5 rreshta)*

Zbatimi do të fillojë menjëherë pas miratimit të projektligjit dhe për një periudhë rreth 6-muaj do të jetë i nevojshëm përgatitja dhe miratimi i akteve nënligjore të parashikuara në projektligj për tu përgatitur. Ministria e Turizmit, Agjencia Kombëtare e Turizmit, Agjencia Kombëtare e Bregdetit dhe njësitë e vetqeverisjes vendore do të bashkëpunojnë për të zbatuar përcaktimet e shtuara në këtë projektligj, nën monitorimin e mbikqyrjen e MTM. Monitorimi do të sigurohet nëpërmjet një procesi vlerësimi të të dhënave që do të administrohen nga institucionet përgjegjëse për turizmin, struktura përgjegjëse për inspektimin dhe nga zbatimi i përcaktimeve të reja ligjore.

## PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

### Historik

*Jepni kontekstin e politikës.*

Përtej vështirësive që ju imponuan sektorit të turizmit, pas situatës dramatike të tërmetit të Nëntorit të vitit 2019 dhe cikleve të njëpasnjëshme të pandemisë së Covid 19, që kulmuan përgjatë vitit 2020 me një rënie prej rreth 60% të numrit të vizitorëve dhe turistëve, industria e turizmit po konsolidohet me një ritëm të qëndrueshëm, si një nga sektorët prioritarë të zhvillimit ekonomik të vendit.

Bazuar në raportin e “Impaktit ekonomik të udhëtimeve dhe turizmit” të vitit 2022, të Këshillit Botëror të Udhëtimit dhe Turizmit (WTTC), përgjatë vitit 2021, sektori i turizmit regjistroi një kontribut total në ekonomi prej 3,1 miliard USD, që përbën rreth 17.4 % të PBB-së, duke e pozicionuar Shqipërinë në vendin e 14-të në botë për kontributin në ekonomi të industrisë së turizmit dhe sipas Indeksit të Zhvillimit të Udhëtimeve dhe Turizmit 2021 të Forumit Ekonomik Botëror (WEF) një nga tre vendet evropiane së bashku me Malin e Zi dhe Kroacinë, me varësinë më të lartë nga ky sektor . Gjithashtu, bazuar në të njëjtin raport, kjo industri, e mirënjohur si punësues intensiv, siguroi punësimin në gjithë zinxhirin e vlerës së turizmit të rreth 226 mijë punonjësve, duke zënë rreth 20 % të numrit të të punësuarve. Përgjatë po të njëjtit vit, të ardhurat e siguruara nga “Turizmi hyrës” I jorezidentëve, arritën në nivelin e 2,4 miliard USD, të cilat përbënë rreth 83% të eksporteve shqiptare dhe në të njëjtën kohë luajtën një rol të rëndësishëm në bilancin e pagesave.

Sipërmarrjet e akomodimit dhe të shërbimeve në funksion të turizmit në vitin 2022 sipas Regjistrimit të Biznesit të INSTAT, u shtuan me rreth 2,000 njësi të reja, duke konfirmuar trendin rritës të kërkesës për leje ndërtimi dhe kërkesës së shtuar për shërbime.

Numri i shtetasve të huaj të hyrë në Shqipëri gjatë vitit 2022 ishte 7.543.817, duke u rritur me 32,6 %, në krahasim me vitin 2021. Evropa ishte burimi kryesor i turistëve që vizituan Shqipërinë, duke zënë një volum prej rreth 91 % të të gjithë turistëve, çka reflekton se akseset < 3 orë nga një destinacion në tjetrin është ende faktor i rëndësishëm për fluksin e udhëtarëve për qëllime turizmi. Megjithatë së fundmi turistë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kina apo vende të tjera të Azisë dhe Lindjes së Mesme, kanë shënuar një interes domethënës rritës, duke inkurajuar kështu indirekt zhvillimin e segmenteve të turizmit, sidomos turizmin historik dhe atë kulturor.

Nën ndikimin e një kërkesë të lartë për shërbimet e turizmit bregdetar, në destinacionet bregdetare të turizmit masiv si Velipoja, Shëngjini, Durrësi, Vlora, Himara, Saranda, Ksamili, është zhvilluar masivisht oferta turistike e bazuar në struktura familjare, dhoma me qira, apartamente dhe vila, duke shfrytëzuar vetëm një pjesë të potencialit të zhvillimit.

Gjithashtu, Tirana si destinacion tashmë i konfirmuar për një sërë nënsegmentesh të turizmit, që kryesisht, në fazën e tanishme të zhvillimit, në pjesën më të madhe, konsumohen nga turistë të organizuar individualisht jo nëpërmjet paketave turistike, ka shënuar një rritje të jashtëzakonshme të infrastrukturës akomoduese, e cila bazohet tek dhoma, apartamente dhe vila me qira.

Sipas të dhënave nga AirDNA – e cila analizon statistikën për strukturat e akomodimit me qira ditore nga platforma Airbnb, – të vëna në dispozicion për revistën “Monitor”, në muajin Qershor 2023, në këtë platformë ishin të listuara për qira ditore rreth 15,375 banesa/apartamente, me një rritje prej 133% në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Ndërkohë po sipas revistës “Monitor”, të dhënat në Booking.com tregojnë se në këtë platformë, janë regjistruar 13,005 struktura me qira ditore, ku 6749 janë shtëpi private dhe 5689 apartamente, ndërsa pjesa tjetër përbëhet nga vila, bujtina, ferma, kamperat etj., pa përfshirë hotelet dhe resortet.

### **Problemi në shqyrtim**

- Përshkruani natyrën e problemit.
- Identifikoni shkaqet e problemit.
- Përshkruani shtrirjen e problemit.
- Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.
- Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.

Ligji 93/2015 "Për turizmi", i ndryshuar u miratua nga Parlamenti Shqiptar në vitin 2015. Me dinamikën e fortë të zhvillimit të kësaj industrie, sidomos 5 vitet e fundit dhe me trendet e reja të udhëtimeve të shfaqura pas pandemisë së COVID 19, me zhvillimin institucional dhe administrativ të institucioneve përgjegjëse për administrimin dhe zhvillimin e këtij sektori në cilësinë e institucioneve publike, me nevojën për të siguruar një sektor konkurrues dhe funksional, me nevojën për të vendosur kritere të përshtatshme për sigurimin e standardeve në ushtrimin e aktiviteteve turistike, janë identifikuar si problematike:

- i. Operimi si struktura akomoduese në mënyrë informale i dhomave, apartamenteve dhe vilave, duke cënuar konkurrencën me subjektet formale, cilësinë e shërbimeve etj;
- ii. Humbja e koherencës së disa funksioneve të parashikuara për t'u siguruar nga Degët Territoriale të Turizmit si dhe nevoja për përmirësimin e funksioneve dhe përgjegjësive të Agjencisë Kombëtare të Turizmit dhe Agjencisë Kombëtare të Bregdetit;
- iii. Mungesa në destinacion e një strukture koordinuese me pushtetin vendor, bizneset e grupet të interesit, në hartimin dhe zbatimin e planeve e programeve të turizmit;
- iv. Nevoja e një procesi efektiv mbi propozimin dhe përzgjedhjen e projekteve- në fushën e turizmit për financim, duke synuar krijimin e një ambienti nxitës për kërkesë - propozime inovative nga çdo individ apo entitet;
- v. Domosdoshmëria për të ripërcaktuar, lehtësuar dhe definuar saktësisht disa procese që lidhen me certifikimin e udhërrëfyesve turistikë, licencimin e operatorëve turistikë dhe agjencive të udhëtimit, parashikimin, përmirësimin dhe lehtësimin e kritereve për ushtrimin e veprimtarisë turistike si "Agroturizëm", "Stacion plazhi" si dhe nevojën për transparencën e çmimeve dhe të procesit të ankimit nga çdo subjekt turistik që i nënshtrohet përcaktimeve të këtij ligji;
- vi. Mungesa e mbledhjes së të dhënave statistikore të plota, të vërteta dhe në kohë reale;
- vii. Mungesa e sigurimit të përgjegjesisë ndaj palëve të treta për subjektet që operojnë në turizëm;
- viii. Nevoja për vendosjen e standardeve dhe rritjen e sigurisë në shtigjet që përdoren për ecje ose kalim përgjatë apo drejt vendndodhjeve të vecanta me interes turistik, me qëllim krijimin e eksperiencave rekreative;
- ix. Nevoja për të përmirësuar mënyrën e kontrollit të zbatimit të përcaktimeve ligjore nga ana e subjekteve dhe vendosjes së masës së gjobës për kundërvajtjet administrative.

Lidhur me sa më sipër, grupet e prekura nga problematikat e identifikuara më lart janë: afektuar kategori të ndryshme:

- a) Qeveria - me mungesën e të ardhurave të mundëshme fiskale dhe rishpërndarjen e tyre si dhe me mos shfrytëzimin e potencialit administrues të proceseve nga institucionet përgjegjëse;
- b) Njësitë e vetëqeverisjes vendore - me mungesën e taksave, tarifave lokale dhe rishpërndarjen e tyre;



- c) Biznesi – sipërmarrësit e shërbimeve të akomodimit të cilët veprojnë si subjekte tregtare, janë ballafaquar me një konkurrencë jo të drejtë nga subjekte jo tregtare që nuk I nënshtrohen asnjë detyrimi tatimor;
- d) Qytetarët/Turistët- nga mungesa e kthimit të të ardhurave të mundëshme tatimore në dobi të përmirësimit të infrastrukturës turistike apo në investime të tjera, funksionet e mbivendosura apo të munguara të institucioneve shtetërore etj.

Bazuar në sa më sipër është vlerësuar që problemet mund të adresohen nëpërmjet politikash të caktuara, të konkretizuara në ndryshimet ligjore të propozuara, të cilat kanë afektuar grupet si vijon:

- a) Qeveria - me mungesën e të ardhurave të mundëshme fiskale dhe rishpërndarjen e tyre si dhe me mos shfrytëzimin e potencialit adminstrues të proceseve nga institucionet përgjegjëse;
- b) Njësitë e vetëqeverisjes vendore - me mungesën e taksave, tarifave lokale dhe rishpërndarjen e tyre;
- c) Biznesi – sipërmarrësit e shërbimeve të akomodimit të cilët veprojnë si subjekte tregtare, janë ballafaquar me një konkurrencë jo të drejtë nga subjekte jo tregtare që nuk I nënshtrohen asnjë detyrimi tatimor;
- d) Qytetarët/Turistët- nga mungesa e kthimit të të ardhurave të mundëshme tatimore në dobi të përmirësimit të infrastrukturës turistike apo në investime të tjera, funksionet e mbivendosura apo të munguara të institucioneve shtetërore etj.

#### **Arsyeja e ndërhyrjes**

- *Shpjegoni pse qeveria e sheh të nevojshme të ndërhyjë.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Turizmi, në vizionin e qeverisë, shihet si sektori që do të garantojë zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, duke siguruar punësim, nxitje të ndërmarrjeve të vogla e të mëdha, më shumë të ardhura e më shumë mirëqenie për qytetarët shqiptarë.

Turizmi është tashmë një sektor ekonomik me ndikim të madh që synon të plotësojë kërkesat e qytetarëve shqiptarë dhe turistëve të huaj për vizita kulturore, kohën e lirë, shëndetin dhe sportin, akomodimin, ushqimin dhe argëtimin, etj, duke ndryshuar pozitivisht strukturën ekonomike, duke krijuar vende të reja pune dhe të ardhura të konsiderueshme ruajtjen e standardeve të shërbimit të ofruar në sektorin e turizmit, si dhe duke kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik të vendit.

Në zbatim të VKM-së nr. 413, datë 19.06.2019 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019–2023 dhe të planit të veprimit”, janë përcaktuar si objektiva strategjike, ndër të tjera, edhe krijimi dhe zhvillimi i industrive të reja, konsolidimi i ofertës turistike, zhvillimi i produkteve dhe shërbimeve të reja në turizëm dhe përmirësimi i cilësisë së tyre etj, realizimi i të cilave kërkon ndryshime ligjore

në legjislacionin për turizmin. Në të njëjtën kohë është konstatuar një nevojë për të përmirësuar funksionalitetin dhe nivelin e administrimit të institucioneve përgjegjëse, Ministri përgjegjëse për turizmin, Degë Territoriale të Turizmit, Agjenci Kombëtare e Turizmit dhe Agjenci Kombëtare e Bregdetit, në funksion të lehtësimit të proceseve certifikuese për shërbimet e turizmit, kryesisht udhërrëfyesit turistikë, stacionet e plazhit etj.

Gjatë zbatimit të ligjit 93/2015, në lidhje me ofrimin e shërbimit të akomodimit është konstatuar se një numër i madh ofruesish të këtij shërbimi të kategorizuara kryesisht në dhoma, apartamente dhe vila, çënojnë mjedisin konkurrues në sektor dhe nuk sigurojnë ofrimin e shërbimeve të standardizuara për konsumatorët.

Nga sa më sipër, është parë e nevojshme ndërhyrja e qeverisë mbi propozimet ligjore të ndryshimit të ligjit për turizmin, përmes së cilave synon të rregullojë:

- \* çështjet e informalitetit dhe cilësisë së shërbimeve në turizëm;
- \* mbrojtjen e konsumatorit nëpërmjet detyrimit të shtuar të cdo sipërmarrësi turistik, ku ky i fundit gjatë ushtrimit të veprimtarisë duhet të ketë një kontratë të vlefshme sigurimi për sigurimin e përgjegjësive ndaj palëve të treta si rezultat i mospërbushjes së detyrimeve, përfshirë aftësinë paguese dhe falimentimin;
- \*riorganizimin e strukturave përgjegjëse në fushën e turizmit si AKT, AKB, në kuadër të rritjes së efikasitetit dhe zbatueshmërisë së funksioneve të tyre;
- \*lehtësimin e proceseve certifikuese të shërbimeve turistike si agroturizmi, strukturave akomoduese etj;
- \*Përcaktimin e rregullave mbi standardizimin dhe administrimin e shtigjeve turistike;
- \*mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave statistikore për turizmin nëpërmjet Këshillit Nderinstitucional për Statistikat, si një organ i ri i ngritur pranë MTM;
- \*ngritjen e një strukture të posaçme/kolegjiumi pranë MTM, për vlerësimin e projekteve dhe veprimtarive në turizëm;
- \*forcimin dhe kontrollin e masave ndëshkuese për moszbatim të kërkesave ligjore për turizmin, duke e kthyer gjyben në titull ekzekutiv.

### **Objektivi i politikës**

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat e vendosur të korrespondojnë me ato të dhëna në përmbledhjen ekzekutive, por më të detajuara.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

Nëpërmjet ndërhyrjeve të propozuara, qeveria shqiptare synon arritjen e objektivave të mëposhtme:

- a) Uljen e informalitetit në ofrimin e shërbimit të akomodimit nëpërmjet identifikimit të ofruesve të akomodimit në segmentin e strukturave akomoduese jotregtare (dhoma, vila, apartamente);

- b) Vendosjen e kushteve standarde për ushtrimin e shërbimit të akomodimit në strukturat akomoduese jotregtare;
- c) Përmirësimin e funksioneve të institucioneve përgjegjëse për turizmin si: Ministria përgjegjëse për turizmin, Agjencia Kombëtare e Turizmit dhe Agjencia Kombëtare e Bregdetit;
- d) Rritja e funksionalitetit të sistemit të certifikimit të shërbimeve turistike (udhërrëfyes turistikë, stacione plazhi etj);
- e) Përmirësimin e procesit të mbledhjes dhe përpunimit të statistikave zyrtare në Republikën e Shqipërisë sipas rregulloreve të vendosura në fushën e statistikave;
- f) Forcimi dhe kontrolli i shkeljeve që përbëjnë kundravajtje administrative në turizëm;

### **Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara**

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë identifikuar opsionet e politikës.*

### **Opsioni 0-(status quo)**

Ky opsion nënkupton mos ndërmarrjen e asnjë politike, duke vijuar me administrimin dhe zhvillimin e sektorit të turizmit në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi dhe posaçërisht të Ligjit Nr. 93/2015, datë 27.7.2015 "Për turizmin", i ndryshuar.

Legjislacioni aktual nuk mundëson uljen e informalitetit në sektor si pasojë e mos rregullimit ligjor të disa kategori ofruesish të tjerë të akomodimit, përmirësimin e funksioneve të strukturave përgjegjëse në fushën e turizmit, ( AKT, AKB etj), lehtësimin e proceseve certifikuese të shërbimeve turistike (agroturizmi, struktura akomoduese etj), vendosjen e standardeve për infrastruktura të reja turistike (standardizimi dhe administrimi i shtigjeve turistike), përmirësimin dhe administrimin e të dhënave statistikore për turizmin, forcimin dhe kontrollin mbi zbatimin e kërkesave ligjore për turizmin etj.

### **Opsioni 1**

Përgatitja e një ligji të ri sektorial. Nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje rregullatore, do të përcaktohen përkufizime, kriteret dhe procedura të reja, institucione përgjegjëse të reja me role dhe përgjegjësi të riformuluara. Përgatitja e ligjit të ri tetë vite pas miratimit të ligjit të mëparshëm, duke sjellë ndryshime thelbësore, do të kërkonte për pasojë një periudhë të rëndësishme tranzicioni, të përshtatjes së industrisë në përputhje me kuadrin e ri rregullator si dhe të strukturave shtetërore për njohjen dhe zbatimin e tij. Gjithashtu

ai do të krijonte një pasiguri tek palët e interesuara për paqëndrueshmërinë e politikave qeveritare përkundrejt zhvillimit të këtij sektori të rëndësishëm të ekonomisë.

## **Opsioni 2**

Ndryshime të legjislacionit ekzistues. Nëpërmjet kësaj politike synohen rregullime në legjislacionin në fuqi për çështje të caktuara që lidhen me zhvillimin e sektorit, të identifikuar si problematike apo në nevojën për përmirësim, përgjatë viteve të zbatimit të tij. Ndryshimet do të jenë të një karakteri të përgjithshëm dhe nuk do të prekin parimet themelore dhe thelbin e ligjit. Ndryshimet e fokusuar në vetëm disa çështje të caktuara, si përmirësime të parashikimeve ligjore në funksion të teknikës legjislative, rishikimin e funksioneve dhe organizmit të institucioneve përgjegjëse për turizmin, mbrojtjen e konsumatorit nëpërmjet detyrimit të shtuar të cdo sipërmarrësi turistik, lehtësimin e proceseve certifikuese të shërbimeve turistike si agroturizmi, stukturave akomoduese, përcaktimin e rregullave mbi standardizimin dhe administrimin e shtigjeve turistike; mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave statistikore për turizmin, vlerësimin e projekteve dhe veprimtarive në turizëm si dhe forcimin dhe kontrollin e masave ndëshkuese për moszbatim të kërkesave ligjore për turizmin, duke e kthyer gjobën në titull ekzekutiv.

Këto ndryshime do të mund të zbatohen më lehtë nga të gjithë palët, sektori privat dhe sektori publik, duke rritur efektivitetin e nismës dhe uljen e kostove.

## **Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve**

- *Identifikoni grupet e prekura.*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur, bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
  - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
  - *Analizoni nga ana sasimore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
  - *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (përdor tabelën në Aneksin 2/a të këtij dokumenti).*
  - *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (nëse ka).*
- *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
  - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
  - *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*
- *Diskutoni kufizimin e analizës:*
  - *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*

- *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*
- *Përmbliidhni vlerësimin e opsioneve:*
  - *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
  - *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*
  - *Paraqisni përlogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (përdor tabelën në Aneksin 2/b të këtij dokumenti).*

Miratimi dhe zbatimi i këtij akti ligjor, do të afektojë disa kategori përfshirë bizneset, qeverinë, njësitë e vetëqeverisjes vendore, qytetarët etj.

**Qeveria:** Të ardhurat shtesë në buxhetin e shtetit priten të jenë kryesisht nga formalizimi i ofertës turistike, që lidhet me subjektet që ofrojnë shërbimin e akomodimit. Të ardhurat shtesë në buxhet priten të jenë rreth 117 milion lekë në 10 vjet. Përveç përmirësimeve të të ardhurave buxhetore, ndërhyrja rregullatore ka efekt pozitiv në krijimin e vendeve të reja të punës, si rrjedhijë e rishpërndarjes së të ardhurave të krijuara.

- **Njësitë e vetëqeverisjes vendore:** Të ardhurat shtesë në buxhetet e qeverisjes vendore, si rrjedhijë e zgjerimit të bazës së subjekteve që i nënshtrohen mbledhjes së taksës së fjetjes.

- **Biznesi në përgjithësi:** ndërhyrjet e reja ligjore do të çojnë në formalizimin e tregut duke siguruar kushtet e një konkurrence të lirë dhe të barabartë, si dhe do të sigurojnë rritjen e standardeve të shërbimit të akomodimit. Përcaktimi i standardeve minimale për ushtrimin e aktiviteti të akomodimit nga këto kategori do të ndikojnë indirekt edhe në operatorë të tjerë, për rritjen e kërkesës konsumatorë për pajisje dhe shërbime. Efekti zinxhir i përfitimeve të këtyre kategorive është vështirë të evidentohet nga ana sasiore.

- **Qytetarët/Turistët-** marrin shërbimin e kërkuar me cilësi dhe siguri më të lartë. Gjithashtu, rishpërndarja e të ardhurave tatimore të krijuara në formën e investimeve apo shërbimeve të përmirësuara, shkon në përfitim të konsumatorëve. Risqet e mundshme për të penguar përmbushjen e pritshmërive pas miratimit të projektligjit të ri “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar, janë si vijojnë:

- 1) Destabiliteti politik, luftërat, konfliktet civile apo fatkeqësitë natyrore të rënda;
  - 2) Mos pjekuria e subjekteve që i nënshtrohen zbatimit të këtij ligji si pasojë e një kulture të konsoliduar të informalitetit. Në lidhje me këtë moment do të jetë i nevojshëm fushata sensibilizuese në njohje të ligjit nga subjekte tsbatuese dhe nga konsumatorët.
- Në përfundim, nisur nga analiza e mësipërme, Opsioni 2, është opsioni më i preferuar, i cili konsiston në paraqitjen e ndryshimeve të legjislacionit ekzistues dhe më konkretisht të ligjit 93/2015 “Për turizmin” i ndryshuar. Ky opsion ka avantazh nga dy opsionet e tjera, pasi përveç argumenteve të mësipërme, nga analiza kosto-përfitim, ky opsion rezulton me efektiv.

### Arsyetimi i opsionit të preferuar

- Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.
- Shpjegoni arsyetimin tuaj.

Opsioni 2, i cili konsiston në paraqitjen e ndryshimeve të legjislacionit ekzistues, është konsideruar si Opsioni i Preferuar. Dimensioni sektorial i projektaktit do të lejojë prezantimin e përkufizimeve të reja, kritereve, procedurave dhe institucioneve të reja, që do të lehtësojnë zhvillimin e nënsektorit të turizmit detar e si pasojë do të sigurojnë një efekt zinxhir që lidhet me rritjen e investimeve, punësimin etj. Përzgjedhja e këtij opsioni do të sigurojë një proces më të qartë dhe më të shkurtër në krahasim me opsionin për të ndërmarrë përmirësime ligjore në legjislacion ekzistues. Zbatimi i këtij opsioni do të sigurojë:

1. Përfshirjen si struktura akomoduese që i nënshtrohen përcaktimeve ligjore të këtij ligji, të dhomave, apartamenteve dhe vilave, me synimin për të krijuar një mjedis konkurrues, shërbime të standardizuara dhe për të minimizuar shkallën e informalitetit të sektorit;
2. Suprimimin e Degëve Territoriale të Turizmit dhe përmirësimin e funksioneve dhe përgjegjësi të Agjencisë Kombëtare të Turizmit dhe Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, duke përmirësuar strukturat institucionale dhe administrimin.
3. Rikonceptimin e strukturës përgjegjëse për përzgjedhjen e projektpropozimeve në fushën e turizmit si dhe lehtësimin e procedurave të aplikimit, përzgjedhjes zbatimit dhe monitorimit, me synim krijimin e një ambienti nxitës për propozime inovative dhe smart nga çdo individ apo entitet;
4. Lehtësimin e procesit të certifikimit të udhërrëfyesve turistikë, përmirësimin e kritereve për ushtrimin e aktivitetit si stacion plazhi si dhe detyrimin për transparencën e çmimeve nga çdo subjekt turistik që i nënshtrohet përcaktimeve të këtij ligji;
5. Përmirësimin e masave ndaj subjekteve për kundravajtjet administrative nga ana e tyre etj;

Kriteret që tregojnë arritjen e objektivit për ndryshimet ligjore nëpërmjet projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 93/2015 "Për turizmin" i ndryshuar" janë:

- a) Efektiviteti në përmirësimin e procedurave të Agjencisë Kombëtare të Turizmit dhe Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, ;
- b) Përmirësimi i standardeve të ofertës turistike;
- c) Rritja e të ardhurave buxhetore (lokale dhe qendrore);
- d) Efektiviteti në zbatimin e procesit të kontrollit dhe forcimit të kundërvajtjeve administrative dhe sanksioneve;

<b>Kriteret</b>	<b>Pesha</b>	<b>Opsioni 0</b> (nuk do të ketë ndryshim /politike të re)	<b>Opsioni 1</b> (Hartimi i aktit të ri)	<b>Opsioni 2</b> Hartimi i aktit ligjor për ndryshimin e ligjit ekzistues
<b>Efektivitet</b> në përmirësimin e procedurave	5	1 (5)	2 (10)	3 (15)
<b>Përmirësimi i standardeve të ofertës turistike;</b>	4	1 (4)	2 (8)	3 (12)
<b>Aftësia për të rritur të ardhurat buxhetore;</b>	3	0 (0)	4 (12)	4 (12)
<b>Efektivitet</b> në zbatimin e procesit të kontrollit dhe forcimit të kundërvajtjeve administrative dhe sanksioneve	3	1 (3)	2 (6)	2 (6)
<b>Efektivitet -Kosto</b>	3	2 (6)	3 (9)	5 (15)
<b>Piket</b>		<b>18</b>	<b>45</b>	<b>60</b>

Opsioni i preferuar është opsioni 2, hartimi i një projektligji për ndryshime në kuadrin ligjor në fuqi. Nga pikpamja e analizës kosto-përfitim, ky është opsioni më fitimprurës në krahasim me opsionet e tjera. Vlera prezente neto aktuale që synohet të arrihet nëpërmjet këtij opsioni është rreth 117 milion lekë për 10 vjet.

#### Çështje të zbatimit

- *Shpjegoni se cila strukturë do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*

[Click here to enter text](#)

#### Faza e monitorimit dhe vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmblendhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e objektivave ose progresin drejt tyre.*

Monitorimi do të udhëhiqet nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për të siguruar zbatueshmërinë dhe efikasitetin e zbatimit të këtij ligji.

Procesi i monitorimit do të mbështetet në tregues të matshëm dhe që sigurojnë një vlerësim sa më realist mbi efektet e zbatimit të opsionit të zgjedhur, më konkretisht:

1. Numri i subjekteve të kategorizuara në kategoritë e reja;
2. Vlera e të ardhurave buxhetore nga tatimi mbi të ardhurën nga qëndrimi aftshkurtër në këto struktura, mbledhja e të ardhurave nga gjobat në turizëm;
3. Vlera e të ardhurave lokale si takse fjetjeje;
4. Rritja e treguesve të punësimit në sektorin e akomodimit;
5. Vlerësimi i të dhënave statistikore;
6. Investimet në zhvillimin e qëndrueshëm në turizëm;
7. Shkeljet/kundravajtjet administrative në turizëm



Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuara në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Pakoni zbritës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kosto për buxhetin - një herë										
Kosto për buxhetin - në vazhdimësi										
Kosto për bizneset - një herë										
Kosto për bizneset - në vazhdimësi										
Kosto për grupet e tjera - një herë										
Kosto për grupet e tjera - në vazhdimësi										
<b>Kosto në total</b>	6,000,000	6,120,000	6,242,400	6,367,248	6,494,592	6,624,484	6,756,974	6,892,114	7,029,956	7,170,555
Pakoni zbritës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Përfitimet për buxhetin - një herë										
Përfitimet për grupet e tjera - një herë										
Përfitimet për grupet e tjera - në vazhdimësi										
Përfitimet për biznesin - një herë										
Përfitimet për biznesin - në vazhdimësi										
<b>Përfitimet totale</b>	20,880,000	20,880,000	20,880,000	20,880,000	20,880,000	20,880,000	20,880,000	20,880,000	20,880,000	20,880,000
<b>Përfitimi zbritur - përfitimi total</b>	19,880,000	19,880,000	19,880,000	19,880,000	19,880,000	19,880,000	19,880,000	19,880,000	19,880,000	19,880,000
Vlera e vlerësimit aktual të biznesit në total	19,880,000	19,880,000	19,880,000	19,880,000	19,880,000	19,880,000	19,880,000	19,880,000	19,880,000	19,880,000
Vlera e vlerësimit aktual të kostos në total	6,000,000	6,120,000	6,242,400	6,367,248	6,494,592	6,624,484	6,756,974	6,892,114	7,029,956	7,170,555
<b>Vlera e vlerësimit aktual të VAN (Vlera e vlerësimit aktual të përfitimit neto dhe vlera e vlerësimit aktual të kostos në total)</b>	13,880,000	13,760,000	13,637,600	13,512,752	13,385,408	13,255,516	13,123,026	12,987,886	12,850,044	12,709,445

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1	147	170	23
Opsioni 2	53	170	117

MINISTËR

MIRELA KUMBARO FURXHI